



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Publikimi Teknik - TP 22

Katalogu i pyetjeve për kandidatët të cilët i nënshtrohen pjesës teorike për marrjen e licencës së pilotit të paraglajdit

Material udhëzues

Parathënie

Ky material udhëzues është i karakterit edukativ dhe ka për qëllim përgatitjen e kandidatëve të cilët i nënshtrohen pjesës teorike të provimit për marrjen e licencës së pilotit të paraglajdit.

Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës (AAC) me datë 10 tetor 2012, ka publikuar Rregulloren nr. 1/2012 për kushtet dhe mënyrën e përdorimit të deltaplanëve dhe paraglajdëve. Sipas kësaj Rregulloreje kandidati duhet t'i nënshtrohet tërë pjesës teorike të provimit për marrjen e licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit apo të autorizimit përkatës, të organizuar dhe zhvilluar nga AAC-ja.

Për t'iu nënshtroar pjesës teorike të provimit, kandidati duhet të ketë rekomandimin me shkrim të organizatës së aprovuar për trajnim të pilotëve të deltaplanit apo paraglajdit, në të cilën është zhvilluar trajnimi, pas përfundimit të suksesshëm të të gjitha elementeve të nevojshme të trajnimit teorik. Rekomandimi i lëshuar nga organizata e aprovuar për trajnim të pilotëve për deltaplan apo paraglajd është i vlefshëm **12** muaj. Nëse gjatë kësaj periudhe kandidati nuk i nënshtrohet provimit teorik, ai/ajo duhet të ofrojë dëshmi për trajnimin shtesë të kryer nga organizata e aprovuar për trajnim të pilotëve për deltaplan apo paraglajd.

Kandidati e kalon me sukses pjesën teorike të provimit nëse ka arritur së paku **75%** të numrit të poenëve të përcaktuar për secilën lëndë. Poenët ipen vetëm për përgjigjet e sakta.

Kandidati duhet të përsërisë tërë provimin teorik nëse pas tentimit të katërt nuk e ka kaluar ndonjë lëndë, apo nëse ka skaduar periudha prej **18** muajve kalendarik prej se aplikuesi ka aplikuar për herë të parë për provim. Para ri-aplikimit për pjesën teorike të provimit kandidati duhet, në përputhje me rekomandimet e AAC-së, të kryejë trajnime shtesë në organizatën e aprovuar për trajnim të pilotëve për deltaplan apo paraglajd.

Suksesi i pjesës teorike të provimit është i vlefshëm për periudhën prej **24** muajve nga data e kryerjes me sukses të tërë provimit teorik nga kandidati. Nëse gjatë kësaj periudhe kandidati nuk i nënshtrohet provimit praktik (fluturimit), atëherë kandidati duhet ta përsërisë provimin teorik në tërësinë e tij.

Në përputhje me privilegjet të cilat i merr bartësi i licencës së pilotit të deltaplanit apo paraglajdit, kandidati duhet të demonstrojë nivelin e njohurive teorike nga lëndët vijuese:

- Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)
- Konstruksioni dhe materialet
- Meteorologjia
- Rregullat dhe legjislacioni
- Teknikat e fluturimit

- Situatat e rrezikshme dhe procedurat e jashtëzakonshme
- Dhënia e ndihmës së parë.

Ky doracak është përgatitur nga AAC si material udhëzues për rregullimin e aviacionit civil. Për shprehjet e ideve në këtë udhëzues mund të pretendohen të drejta autoriale në rast se ekziston dyshimi për një shkelje të tyre. Përgatitja e një publikimi tjetër të kësaj natyre mund të ndalohej përveç nëse dallon substancialisht nga ky udhëzues, dhe nëse nuk është kopje e tij.

Nëse keni nevojë për informata shtesë, ju lutem të na shkruani në adresën e mëposhtme:

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës

Lagjja Arbëria

Rruga Ahmet Krasniqi p.n.

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

e-mail: infocaa@caa-ks.org

Tel: +38 1 38 248 629

Fax: +38 1 38 211 009

Dritan Gjonbalaj
Drejtor i Përgjithshëm

nëntor 2014

Lista e faqeve efektive

Titulli	Faqe	Nr. Rev.	Data efektive
Parathënie	2 nga 56	Original	20.11.2014
Lista e faqeve efektive	4 nga 56	Rev. 1	26.01.2015
Tabela e aprovimit	5 nga 56	Original	20.11.2014
Lista e distribuimit / Tabela e revidimit	6 nga 56	Original	20.11.2014
Tabela e përmbajtjes	7 nga 56	Original	20.11.2014
Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)	8 nga 56	Original	20.11.2014
Konstruksioni dhe materialet	17 nga 56	Original	20.11.2014
Meteorologjia	20 nga 56	Original	20.11.2014
Rregullat dhe legjislacioni	25 nga 56	Original	20.11.2014
Teknikat e fluturimit	32 nga 56	Original	20.11.2014
Situatat e rrezikshme dhe procedurat emergjente	37 nga 56	Original	20.11.2014
Mjekësia e aviacionit dhe ndihma e parë	41 nga 56	Original	20.11.2014
Lista e përgjigjeve të sakta	45 nga 56	Rev. 1	26.01.2015

Tabela e aprovimit

	Emri dhe pozita	Data	Nënshkrimi
Përgatitur nga:	DSF	14.11.2014	
Autorizuar nga:	Kushtrim Musa Drejtore, DSF	19.11.2014	
Kontrolli i cilësisë:	Lendita Kika-Berisha Menaxher e cilësisë	20.11.2014	
Aprovuar nga:	Dritan Gjonbalaj Drejtore i përgjithshëm	20.11.2014	

Lista e distribuimit

Kopje nr.	Vendndodhja	Media	Sasia
1	Libraria e AAC-së	Origjinali	1
2	Serveri i dosjeve të AAC-së	Digjitale	1

Tabela e revidimit

Nr. Rev.	Datë	Përgatitur nga:	Autorizuar nga:

Tabela e përmbajtjes

Parathënie.....	2
Lista e faqeve efektive	4
Tabela e aprovimit	5
Lista e distribuimit / Tabela e revidimit	6
Tabela e përmbajtjes	7
Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)	8
Konstruksioni dhe materialet.....	17
Meteorologjia.....	20
Rregullat dhe legjislacioni.....	25
Teknikat e fluturimit.....	32
Situatat e rrezikshme dhe procedurat emergjente	37
Mjekësia e aviacionit dhe ndihma e parë	41
Lista e përgjigjeve të sakta	45

Teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)

1. Cilat janë dy parimet sipas të cilave krahu e gjeneron/krijon ngritjen?
 - a) Parimi i Bernoullit dhe Parimi i Darvinit
 - b) Ligji i Njutonit për lëvizjen dhe Parimi i Darvinit
 - c) Parimi i Bernoullit dhe Ligji i Njutonit për lëvizjen
2. Deklarata “për çdo veprim (forcë) në natyrë ekziston një reaksion i barabartë dhe i kundërt” është?
 - a) Parimi i Bernoullit
 - b) Ligji i tret i Njutonit për lëvizjen
 - c) Parimi i Darvinit
3. Cilat janë katër forcat që veprojnë në një mjet ajror gjatë fluturimit?
 - a) ngritja, shtytja, vektori, rezistenca
 - b) gravitetit, rezistenca, shtytja, energjia
 - c) ngritja, gravitetit, shtytja, rezistenca
 - d) rezistenca, gravitetit, ngritja, krahu
4. Për fluturimin e nivelizuar të pa nxituar, cila është e saktë:
 - a) shtytja = gravitetin dhe ngritjen = rezistencën
 - b) rezistenca = gravitetin dhe ngritjen = shtytjen
 - c) graviteti = shtytjen dhe ngritjen = rezistencën
 - d) ngritja = gravitetin dhe shtytjen = rezistencën
5. Çka është këndi i sulmit?
Shpjego dhe vizato.
6. Cilët faktorë ndikojnë në rezistencën e një objekti?
 - a) sipërfaqja e objektit të ekspozuar ndaj erës
 - b) shpejtësia e erës
 - c) dendësia e ajrit
 - d) forma e objektit
 - e) të gjitha të shënuara më lart
7. Raporti ndërmjet rezistencës dhe sipërfaqes së ekspozuar është linear. Nëse sipërfaqja e ekspozuar e një objekti në erë (V) rritet nga 2 m^2 në 4 m^2 çfarë ndodh me rezistencën?
 - a) kjo e dyfishon sipërfaqen e ekspozuar dhe për këtë arsye edhe rezistenca dyfishohet
 - b) edhe rezistenca zvogëlohet për dy herë
 - c) rezistenca katërfishohet
 - d) kjo e dyfishon sipërfaqen e ekspozuar dhe për këtë arsye rezistenca mbetet e njëjtë
8. Raporti ndërmjet shpejtësisë së erës dhe rezistencës është:
 - a) jo linear
 - b) linear

9. Vektori paraqet dukuri të caktuara fizike të karakterizuara nga madhësia, drejtimi dhe pika e origjinës.
- a) e saktë
 - b) e pasaktë

10. Në skicën e mëposhtme të prerjes së tërthortë të krahut të paraglajdit paraqitni termet në vijim:
- a) Graviteti
 - b) Rezistenca
 - c) Ngritja
 - d) Rrjedha relative e ajrit
 - e) Vija e kordës
 - f) Këndi i sulmit



11. Çfarë e shtyn paraglajdin për të lëvizur përpara në fluturim?

Përsbkruid.

12. Forma e paraglajdit është profil ajror (airfoil), por ajo është e butë dhe e pa formë në tokë. Si formohet dhe mbahet forma gjatë fluturimit?

Përsbkruid.

13. Në çfarë rrethanash mund të pësojë kolaps profili ajror (airfoil) i krahut të butë?

Përsbkruid.

14. Çfarë është raporti i gjatësisë/gjerësisë (Aspect Ratio)?

- a) raporti i gjatësisë/gjerësisë është i barabartë me shtrirjen e krahëve (wing span) në katror, pjesëtuar me sipërfaqen e krahëve (wing area).
- b) raporti i gjatësisë/gjerësisë është sipërfaqja e krahëve (wing area) e pjesëtuar me shtrirjen e krahëve (wing span).
- c) raporti i gjatësisë/gjerësisë është rrjedha e ajrit (air flow) në katror e pjesëtuar me sipërfaqen e krahëve (wing area).

15. Në përgjithësi, paraglajdët me raport të gjatësisë/gjerësisë (aspect ratio) të ulët kanë performancë të ulët dhe janë më stabil.

- a) e saktë
- b) e pasaktë

16. Paraglajdët me raport të gjatësisë/gjerësisë (aspect ratio) të lartë kanë performancë më të lartë dhe nuk janë shumë stabil.

- a) e saktë
- b) e pasaktë

17. Çfarë është palosja asimetrike (kolapsi asimetrik)?

- Një ngjarje që ndodh kur të dyja anët e krahut të paragjajdit humbin ngarkimin e tyre.
- Një ngjarje që ndodh kur njëra anë e krahut të paragjajdit humb ngarkimin e tij dhe nuk është më profil ajror (airfoil) i ngurtë.
- Një ngjarje që ndodh kur krahu i paragjajdit humb orientimin e tij.

18. Kur është më e zakonshme që të ndodhë palosja asimetrike (kolapsi asimetrik)?

- Ndodhia më e zakonshme është kur piloti fluturon në zonat me aktivitete termike.
- Ndodhia më e zakonshme është kur piloti fluturon në zonat me lartësi të madhe (high altitude).
- Ndodhia më e zakonshme është kur piloti fluturon në zonat mbi oqeanë dhe liqene.

19. Palosjet asimetrike (kolapset asimetrike) janë rezultat:

- i erës së gërshetuar/rrëshqitëse (wind shear)
- i rrebesheve të shiut (rain showers)
- i turbulencës në masën e ajrit në të cilën është duke fluturuar paragjajdi.

20. Kujt i referohet termi “Veshë të mëdhenj” (Big Ears)?


- Manovrim i përdorur nga pilotët e paragjajdit për të rritur shpejtësinë e rënies së tyre.
- Manovrim i përdorur nga pilotët e paragjajdit për të rritur shpejtësinë e ngritjes së tyre.
- Manovrim i përdorur nga pilotët e paragjajdit për të rritur shkallen e animit.

21. Definoni:

- Raportin e planerimit (glide ratio):
- Shkallen e zhytjes (sink rate):
- Ngarkesën e krahut (wing loading):

22. Ilustroni:

- Rrotullimin rreth boshtit vertikal (yaw)
- Rrotullimin rreth boshtit lateral (pitch)
- Rrotullimin rreth boshtit longitudinal (roll)



23. Sa do të jetë shpejtësia tokësore kur fluturoni me 20 km/h të shpejtësisë ajrore (airspeed), nëse:

- a) era ballore është 10 km/h _____
- b) era në bisht është 20 km/h _____
- c) era ballore është 30 km/h _____

24. Cilat janë efektet e:


- a) Ngarkesës së lehtë të krahut (nën specifikimet e prodhuesit)
- b) Ngarkesës së rëndë të krahut (mbi specifikimet e prodhuesit)

25. Dendësia e ajrit (dhe shtypja e ajrit) _____ me rritjen e lartësisë.

- a) rritet
- b) mbetet e njëjtë
- c) zvogëlohet
- d) asnjëra nga përgjigjet e mësipërme

26. Gjatë fluturimit ajri rrjedh mbi dhe nën paraglajd; në sipërfaqen e epërme ekziston një fenomen i thithjes (shtypja negative ose shtypja e ulët), sikur krahu të thithej nga një fshesë elektrike, ashtu që ana e poshtme përjeton shtypje pozitive ose shtypje të lartë, sikur ta frynte një ventilator.

Siç u tha me lart, përcaktoni se cila figurë e paraqitur më poshtë është e saktë?




27. Shtypja negative (thithëse) është rreth (siç është paraqitur përmes përgjigjes së saktë në figurën e mësipërme):

- a) dy herë më e lartë se shtypja pozitive së cilës i nënshtrohet pjesa e poshtme.
- b) e njëjtë me shtypjen pozitive së cilës i nënshtrohet pjesa e poshtme.
- c) shtatë herë më e lartë se shtypja pozitive së cilës i nënshtrohet pjesa e poshtme.

28. Duke përdorur figurën e mëposhtme, përcaktoni drejt me sa vijon:

- a) gjatësia e profilit;
- b) korda mesatare (vija e kordës) e profilit;
- c) tehu i pasëm;
- d) trashësia e profilit;
- e) këndi ndërmjet drejtimit të rrjedhës së ajrit (erës relative) dhe kordës mesatare të profilit;
- f) tehu i përparmë.



1. gjatësia (a): _____
2. gjatësia (b): _____
3. gjatësia (c): _____
4. pika (d): _____
5. pika (e): _____
6. këndi i sulmit (i): _____

29. Nga cilët faktorë varet ngritja?

- a) madhësia e krahut;
- b) koeficienti i ngritjes;
- c) dendësia e ajrit;
- d) shpejtësia e erës;
- e) nga të gjitha më lart.

30. Kur një objekt është i gjatë dhe i sheshtë (p.sh. një krah) dhe i nënshtrohet një ere të pjerrët, dy forca pingule veprojnë në objekt: rezistenca, paralele me erën në të njëjtin drejtim, (si çdo objekt) dhe ngritja, pingule me erën, në drejtim të sipërfaqes së epërme.


- a) e saktë
- b) e pasaktë

31. Cilat janë dy forcat pingule që veprojnë në objektin i cili i nënshtrohet erës së pjerrët?

- a) krah dhe ngritja
- b) rezistenca dhe forca
- c) ngritja dhe rezistenca
- d) asnjëra nga përgjigjet e mësipërme


32. Përcaktoni pikat e rëndësishme aerodinamike të profilit të paraqitur në figurën e mëposhtme sipas deklaratave të sakta të dhëna më poshtë:

- a) Pika e stagnimit apo pika ndërprerjes (breakpoint) _____
- b) Qendra e shtytjes _____
- c) Pika e thyerjes së ngritjes (stall) _____




1. pika në teahun e përparmë ku rrjedha e ajrit ndahet ndërmjet sipërfaqes së epërme dhe të poshtme;

2. pika në sipërfaqen e epërme ku rrjedha e ajrit shkëputet nga sipërfaqja e krahut dhe pas së cilës ndodh turbulenca e cila paraqet një komponent të ngritjes negative;
 3. pika ku të gjitha forcat e aerodinamike (ngritja dhe rezistenca) veprojnë në mënyrë efektive.
33. Përputh deklaratat në vijim me figurën e saktë si më poshtë:
1. ngritja është zvogëluar dhe rezistenca është rritur. Pika e thyerjes së ngritjes (stall) (X) shfaqet në sipërfaqen e sipërme. Pas kësaj pike rezulton turbulenca në një komponent të rënies së shtypit te poshtë, i cili zëvendëson shtyp negative: _____
 2. efekti optimal (10-15°), me një ngritje të konsiderueshme dhe rezistencë të reduktuar përmes shtypit të ulët në sipërfaqen e sipërme dhe shtypjes së qëndrueshme dhe efektive në sipërfaqen e poshtme: _____
 3. ndërkohë që rezistenca vazhdon, shtypja negative vazhdon në sipërfaqen e sipërme, dhe në një masë më të vogël në sipërfaqe e poshtme. Këto forca e kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe rezultojnë në një ngritje shumë të vogël: _____
 4. qarkullimi i ajrit në sipërfaqen e poshtme ndikon në shtypje negative, dhe në sipërfaqen e sipërme në shtypje pozitive. Me këto efekte të cilat veprojnë teposhtë, profili tani ka një ngritje negative: _____



34. Raporti ndërmjet ngritjes dhe rezistencës të krahut (profil), varet kryesisht nga këndi i sulmit (angle of attack).
- a) e saktë
 - b) e pasaktë
35. Duke përdorur grafikonin si më poshtë, përshkruani çfarë është duke ndodh me ngritjen (P) dhe rezistencën (T) në piken:



a) 10°

b) 20°

c) 25°

36. Duke përdorur grafikunin e mësipërm përcaktoni të saktën:

a) 10°

b) 20°

c) 25°

1. ngritja është në maksimumin e saj, mirëpo me efektin shoqërues të një rezistence relativisht të lartë. Kjo ndërlidhet me shkallën minimale të rënies;
2. ngritja zhduket dhe krahut humb forcën ngritëse (stall) (d.m.th. nuk është më duke fluturuar). Në grafikun shihet se përtej pikës së efikasitetit maksimal, në qoftë se këndi i sulmit zvogëlohet ose rritet, atëherë C_z (ngritja) zvogëlohet ose rritet respektivisht;
3. raporti në mes të ngritjes dhe rezistencës është në maksimumin e tij, i cili ndërlidhet me efikasitetin maksimal dhe me këndin më të mirë të planerimit. Me rritjen e këndit të sulmit, forca ngritëse (lift) rritet, mirëpo rezistenca po ashtu rritet në masë më të madhe.

37. Përse bëhet ngritja dhe aterrimi direkt në erë?

38. Çfarë është thyerja e ngritjes (stall):

a) Përshkruaje:

b) Rreziqet:

39. Cili është dallimi në aerodinamikë në mes të thyerjes së ngritjes (stall) parashutale dhe thyerjes së ngritjes (stall) së plotë?

40. Shpjegoni:

a) lëvizjet kontrolluese dhe parimet:

b) kontrollimi i shpejtësisë dhe kthesat (turns):

c) përdorimi i frenave kundrejt lëvizjes/zhvendosjes së peshës:

41. Përshkrimi i:

a) rrotullimit rreth boshtit vertikal (Spin):

b) spirales:

Konstruksioni dhe materialet

42. Si ruhen pajisjet e paraglajdit?

43. Cili është afati kohor për verifikimin teknik të paraglajdit?

44. Çfarë duhet të bëni me paraglajdin nëse ju aterroni në ujë të kripur?

45. Kush duhet të bëjë paketimin e parashutës rezervë, dhe cili është afati kohor?

46. Çka është krahu i paraglajdit?

47. Cilat janë klasifikimet e paraglajdëve?

48. Çfarë duhet të përmbajë doracaku për përdorimin e rripave?

49. Çka është kupola (canopy)?

50. Cili është qëllimi i varëses së paraglajdit?

51. Varësja e paraglajdit përbëhet nga:

52. Cili është qëllimi i rripit të paraglajdit?

53. Cilët faktorë mekanik ndikojnë në zvogëlimin e forcës dhe dëmtimin e paraglajdit?

54. Çfarë është korda (chord)?

55. Cilat janë karakteristikat kryesore të profilit?

Meteorologjia

56. Çka nënkuptoni me shkurtesën VFR?

57. Çka nënkuptoni me shkurtesën VMC?

58. Në përgjithësi me rritjen e lartësisë çfarë ndodhë:

- a) temperatura, shtypja e ajrit dhe dendësia ulen.
- b) temperatura ulet, ndërsa shtypja e ajrit dhe dendësia rriten.
- c) temperatura dhe shtypja e ajrit rriten, ndërsa dendësia zvogëlohet.

59. Nëse në sipërfaqen e tokës temperatura është 15°C, sa do të jetë temperatura në lartësinë 3000 shputa (*feet*)?

- a) 11 °C
- b) 5 °C
- c) 9 °C
- d) 7 °C

60. Në cilin nivel të atmosferës aktivitetet atmosferike janë më të mëdha?

61. Cili është shkaktari kryesor i ndryshimit të motit?

- a) ndryshimi i përqindjes së lagështisë?
- b) ngrohja jo e barabartë e sipërfaqes së tokës?
- c) rrotullimi i tokës dhe efekti i saj në lëvizjen e masave ajrore me shtypje të lartë dhe të ulët.

62. Çfarë mund të ndodhë kur fluturoni përmes frontit?

- a) ndryshimi i shtypjes së ajrit
- b) ndryshimi i temperaturës
- c) ndryshimi i drejtimit të erës
- d) të gjitha më lartë

63. Cilët janë përbërësit themelor të nevojshëm për formimin e stuhisë?

- a) ajri jo stabil
- b) ngritja vertikale e erës (updraft)
- c) lagështia e ajrit relativisht e lartë
- d) të gjitha më lartë

64. Nëse masa ajrore ngrohet nga poshtë, a bëhet ajo më e qëndrueshme?

- a) po
- b) jo

65. Cila nga këto dukuri gjithmonë është e ndërlidhur me një stuhi?
- shiu me intezitet të lartë
 - vetëtima
 - ngricë e ashpër
66. A mund të hasni në breshër në largësi prej disa kilometrave nga vendndodhja e stuhisë?
- po
 - jo
67. Me cilët parametra meteorologjik piloti duhet të jetë i informuar para fluturimit?
- _____
 - _____
 - _____
 - _____
68. Çka kupton kur shërbimi i informatave meteorologjike ju jep informatën për erën 270/5?
-
69. Kur mund të pritët një frymë/erë e rrezikshme?
- nëse kemi ulje të temperaturës në nivel të ulët, zonë frontale, dhe turbulencë të fortë në ajër.
 - kur ajri i qëndrueshëm kalon mbi pengesën malore dhe të cilat formojnë re.
 - pas kalimit të frontit.
70. Stabiliteti i atmosferës përcaktohet përmes?
- temperaturës në sipërfaqe
 - kushteve aktuale të motit
 - shtypjes atmosferike
71. Vëzhgimet e motit në mëngjes, zakonisht parashikojnë mundësinë e kushteve të mira atmosferike gjate tërë ditës nëse kemi:
- qiell të pastër dhe erëra sipërfaqësore 10 nyje ose më pak
 - formim të reve Stratus dhe erëra sipërfaqësore 5 nyje ose më pak
 - lëvizje të frontit me shtypje të ulët atmosferike dhe erëra sipërfaqësore 5 nyje ose më pak.
72. Cili është treguesi më i besueshëm se keni fluturuar përmes frontit?
- ndryshimi i shtypjes
 - ndryshimi i temperaturës
 - ndryshimi i drejtimit të erës
73. Si quhen retë me të ulëta mbi sipërfaqen e tokës?
- Cirrus
 - Altostratus
 - Stratus

74. A mund të hasni në breshër nëse ndodheni disa kilometra larg nga stuhia?

- a) po
- b) jo

75. Nëse nuk keni tregues të erës, çfarë mund të përdorni për përcaktimin e drejtimit të erës?

- a) _____
- b) _____

76. Përshkruaj çfarë nënkupton me shprehjen front i ftohtë?

77. Përshkruaj çfarë nënkupton me shprehjen front i nxehtë?

78. Çfarë është mjegulla?

79. Çfarë është era?

80. Çfarë është meteorologjia?

81. Çfarë është METAR?

82. Si quhen vijat në hartat meteorologjike që bashkojnë vijat me temperatura të njëjta:

- a) Izoterme
- b) Izonefe
- c) Izohjete
- d) Izobare

Rregullat dhe legjislacioni

83. Cila Rregullore e rendit juridik të Republikës së Kosovës rregullon kushtet dhe mënyrën e përdorimit të paraglajdëve?

84. Çka nënkupton shkurtesa AIP?

85. Çka nënkupton shkurtesa VMC?

86. Cili është definicioni i termit “mjet ajror” (aircraft)?

87. Cili është definicioni i termit “fushë ajrore” (airfield)?

88. Cili është definicioni i termit “kohë e fluturimit” (flight time)?

89. Cili është definicioni i termit paraglajd?

90. A ka nevojë të kryhet verifikimi teknik pas çdo riparimi të madh apo modifikimi të paraglajdit?

- a) po
- b) jo

91. Çka lëshohet pas përfundimit të verifikimit teknik?

92. Kush e lëshon certifikatën e përputhshmërisë pas përfundimit të verifikimit teknik?

93. Në sa kopje lëshohet certifikata e përputhshmërisë?

94. Përveç kërkesës për aprovimin e vendit për ngritje dhe aterrim, operatori duhet të dorëzojë? *(rrumbullakeso cilat përfshihen)*

- a) opinionin e personit nga lista e ekspertëve mbi pranueshmërinë e lokacionit të përzgjedhur për qëllimin e kërkuar;
- b) pëlqimin e pronarit apo shfrytëzuesit të tokës në të cilën gjendet vendi për ngritje apo aterrim;
- c) aprovimin e autoriteteve kompetente komunale;
- d) nëse vendi për ngritje apo aterrim gjendet në një zonë të mbrojtur (park nacional), opinionin e ministrisë përkatëse në lidhje me ndikimin që vendi për ngritje apo aterrim mund ta ketë nga pikëpamja e mbrojtjes së mjedisit;
- e) aprovimin e operatorit të aerodromit, nëse vendi për ngritje apo aterrim është vendosur në zonën e aerodromit. Nuk lejohet vendi për ngritje apo aterrim në hapësirën ajrore të kontrolluar;
- f) udhëzimet për shfrytëzimin e vendit për ngritje apo aterrim;

95. Nëse diferenca në lartësi në mes të vendit për ngritje dhe aterrim është më pak se 150 m dhe nëse piloti gjatë kohës së fluturimit, nuk është më shumë se 50 m mbi tokë, a nevojitet aprovimi i AAC-së për vendet për trajnim?

- a) po
- b) jo

96. Në çfarë kushte kryhen operimet me paraglajd? *(rrumbullakeso cilat përfshihen)*

- a) kushtet meteorologjike vizuale (VMC),
- b) hapësirë ajrore të pakontrolluar të klasës G, sipas publikimit të informatave aeronautike (AIP), të republikës së Kosovës,
- c) zonën e aerodromit, paraprakisht të aprovuar nga operatori i aerodromit,
- d) hapësirën ajrore të kontrolluar me një autorizim të veçantë të lëshuar nga ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror.

97. Cila është lartësia minimale që paraglajdët mund të fluturojnë mbi ura, rrugë, hekurudha, linja elektrike, ashensorë të skijimit, antena apo struktura të ngjashme dhe grupe të njerëzve?

98. Ku ndalohet fluturimi me paraglajd? *(rrumbullakeso cilat përfshihen)*

- a) mbi zonat e deklaruara të ndaluara,
- b) në kushte të pafavorshme të motit,
- c) në re,
- d) në largësinë vertikale prej më pak se 150 m (500 shputa) nën bazën e reve,
- e) nën ura dhe objekte të ngjashme, linja elektrike të transmisionit dhe antena.

99. Cilat rregulla aplikohen për përbalkalim? *(rrumbullakeso cilat përfshihen)*
- kur dy paraglajd fluturojnë në të njëjtën lartësi apo afër së njëjtës lartësi me njëri tjetrin, të dy paraglajdët duhet të kthehen në anën e djathtë, ashtu që distanca në mes tyre të jetë së paku 50 metra;
 - kur dy paraglajd fluturojnë në të njëjtën lartësi apo afër së njëjtës lartësi me njëri tjetrin dhe me terren me pjerrtësi anash tyre, përparësi ka ai me terrenin në anën e tij të djathtë. Paraglajdi me terrenin në anën e tij të majtë duhet të kthehet në të djathtë për të siguruar distancën e nevojshme ndërmjet tyre prej së paku 50 metrave.
100. Cilat rregulla aplikohen për tejkalim? *(rrumbullakeso cilat përfshihen)*
- paraglajdi më i ngadalshëm ka përparësi;
 - kur paraglajdi që fluturon më shpejtësi më të madhe ajrore, takon, përafërsisht në të njëjtën lartësi, paraglajdin tjetër që fluturon në të njëjtin drejtim me shpejtësi më të vogël ajrore, ai mund ta tejkalojë atë duke u kthyer djathtas;
 - paraglajdi nuk duhet të tejkalojë paraglajdin tjetër afër terrenit me pjerrtësi, nëse terreni gjendet në anën e djathtë në raport me drejtimin e fluturimit;
 - nëse terreni me pjerrtësi është në anën e majtë në raport me drejtimin e fluturimit, tejkalimi lejohet, me kusht që paraglajdi që fluturon me shpejtësi më të madhe ajrore e tejkalon paraglajdin me shpejtësi më të ultë ajrore nga ana e djathtë.
101. Cilat rregulla aplikohen në kryqëzimin e vijave të fluturimit? *(rrumbullakeso cilat përfshihen)*
- me kryqëzim të vijave të fluturimit nënkuptohet kur vija e fluturimit të një paraglajdi kryqëzohet me vijën e fluturimit të një paraglajdi tjetër në kënd prej 70 deri në 160 shkallëve;
 - kur ndodhë kryqëzimi i vijave të fluturimit të paraglajdëve që fluturojnë përafërsisht në të njëjtën lartësi, përparësi ka paraglajdi që vjen nga ana e djathtë e paraglajdit tjetër. Paraglajdi që nuk ka përparësi duhet të kthehet në mënyrë që t'ia lëshojë rrugën atij që ka përparësi.
102. Cilat rregulla aplikohen për fluturim në shtyllë të njëjtë termike? *(rrumbullakeso cilat përfshihen)*
- kur disa paraglajd, fluturojnë në të njëjtën shtyllë termike, përparësi ka ai që ka filluar rrotullimin i pari;
 - paraglajdët duhet të rrotullohen në të njëjtin drejtim (majtas apo djathtas).
103. Cilat rregulla aplikohen për aterrim? *(rrumbullakeso cilat përfshihen)*
- kur disa paraglajd janë duke aterruar, në një interval të shkurtë kohor, në të njëjtin vend për aterrim, përparësi ka ai që gjendet në lartësinë më të ultë, përveç nëse një paraglajd tjetër është:
 - në fazën finale të aterrimit, apo
 - në rrezik.
 - në të gjitha situatat tjera gjatë fluturimit, duhet të aplikohen dispozitat e rregullave të ajrit (Rules of the Air) ashtu siç janë paraparë në Ligjin nr. 03/L-051 për aviacionin civil.
104. Listo pajisjet e nevojshme që duhet të përdoren gjatë gjithë kohës së operimit me paraglajd?
- helmeta;

- b) parashuta për shpëtim;
- c) radio-komunikimi;
- d) matësi i lartësisë (altimeter).

105. Kur lejohet fluturimi akrobatik?

106. Cila është mosha minimale e lejuar për pilotin nxënës?

107. Sa orë të përgjithshme të fluturimit duhet ti ketë piloti nxënës që të kandidoj për licencën e pilotit për paragjajdit?

108. Cila është mosha minimale për t'ju nënshtrohet provimit për marrjen e licencës së pilotit të paragjajdit?

109. Në cilat lëndë teorike kandidati duhet të demonstrojë nivelin e njohurive? (*rrumbullakeso cilat përfshihen*)

- a) teoria e fluturimit (aerodinamika dhe mekanika e fluturimit)
- b) konstruksioni dhe materialet
- c) meteorologjia
- d) rregullat dhe legjislacioni
- e) teknikat e fluturimit
- f) situatat e rrezikshme dhe procedurat e jashtëzakonshme
- g) dhënia e ndihmës së parë.

110. Sa herë mund të përsëris provim teorik kandidati që e nuk ka përfunduar me sukses ndonjëherë nga lëndët e trajnimit teorik?

111. Për çfarë periudhe kohore vlen rezultati i pjesës teorike i kaluar me sukses?

112. Sa herë ka të drejtë të hyjë në provim praktik (fluturim) kandidati që e ka përfunduar provimin teorik?

113. Cilat dokumente duhet t'i mbajë gjithmonë me vete gjatë fluturimit piloti i paraglajdit?

114. Sa është periudha e vlefshmërisë së licencës të pilotit të paraglajdit?

115. Çfarë autorizimi mund të marrë piloti i paraglajdit?

- a) _____
- b) _____
- c) _____
- d) _____

116. Sa është periudha e vlefshmërisë së autorizimeve të pilotëve të paraglajdit?

117. Cilat janë kushtet për arritjen e autorizimit si instruktor i fluturimit për paraglajd?

118. Cilat janë kushtet për arritjen e autorizimit për fluturim akrobatik me paraglajd?

119. Cilat janë kushtet për arritjen e autorizimit për pilot tandem me paraglajd?

120. Cilat janë kushtet për arritjen e autorizimit për pilot testues me paraglajd?

121. Cilat janë kushtet për pranimin e licencave të huaja në Republikën e Kosovës?

- a) _____
- b) _____
- c) _____
- d) _____

122. Sa është norma në përqindje, për të kaluar me sukses provimin teorik me shkrim?

Teknikat e fluturimit

123. Sipas FAI-së cilat janë 5 fazat e paraglajdzimit?

- a) përreth shtetit (cross country);
- b) ngritje (soaring) e avancuar;
- c) ngritje (soaring) bazike;
- d) planerim në lartësi;
- e) fluturim (skimming) në afërsi të tokës;
- f) asnjë nga lart;
- g) të gjitha nga lart;
- h) sipas FAI ka vetëm 3 faza dhe ato janë: e, d dhe a.

124. Aftësia e pilotit për të fluturuar me paraglajd mund të ndahet në këto cilësi, të cilat zhvillohen përmes?

- a) njohurisë;
- b) aftësisë;
- c) përvojës;
- d) mjeshtërisë së pilotimit (airmanship);
- e) asnjërës nga lart;
- f) të gjitha më lart;
- g) vetëm: a, c dhe d.

125. Njohuritë dhe përvoja janë vetëm "mjete" që përdoren për të përmirësuar aftësitë e pilotit, mjeshtërinë e pilotimit (airmanship) dhe rrjedhimisht kompetencën e saj/tij si pilot.

- a) e saktë
- b) e pasaktë

126. Si do ta përshtatni shpejtësinë tuaj për të arritur raportin më të mirë të planerimit në kushte pa erë?

127. Gjatë fluturimit afër vargmalit, kur dy paraglajdistë takohen në të njëjtën lartësi, cili prej tyre ka përparësi?

128. Para se të filloni fluturimin në drejtim me erën (downwind) përgjatë një vargmali, cilët faktorë duhet të merren parasysh?

129. Cilat janë disa nga mënyrat më të përshtatshme për të përcaktuar drejtimin dhe shpejtësinë e erës gjatë fluturimit?

130. Cilat janë rregullat kur dy paragjajdistë afrohen përballë njëri tjetrit përgjatë një vargmali?

131. Kur dy paragjajdistë janë në drejtime me rrezik për përplasje, çfarë veprimi duhet të ndërmarrin ata?

- a) të dytë kthehen në të djathtë
- b) paragjajdi më i ngadaltë ka prioritet
- c) të dytë kthehen në të majtë

132. Kur dy paragjajdistë fluturojnë në drejtime që kryqëzohen (converging):

- a) të dy paragjajdistët duhet të fillojnë veprime të shmangies.
- b) paragjajdisti në të majtë duhet të fillojë veprimin e shmangies.
- c) paragjajdisti në të djathtë duhet të fillojë veprimin e shmangies.

133. Kur paragjajdistët janë duke u ngritur në fluturim (soaring) në afërsi të kodrës dhe janë duke u afruar përballë njëri tjetrit, atëherë:

- a) të dy paragjajdistët duhet të fillojnë veprime të shmangies
- b) paragjajdisti që e ka kodrën në të djathtë duhet të fillojë veprimin e shmangies
- c) paragjajdisti që e ka kodrën në të majtë duhet të fillojë veprimin e shmangies

134. Kur e tejkaloni një paragjajd tjetër mbi një vargmal (ridge), ju duhet:

- a) ta tejkaloni në të djathtë
- b) ta tejkaloni në të majtë
- c) ta tejkaloni në anën e kodrës

135. Për t'u futur në manovrën 'Big Ears' tërhiq jashtë dhe poshtë:

- a) zgjatësit (risers) "A" më të jashtëm
- b) zgjatësit (risers) "C"
- c) zgjatësit (risers) "A" më të brendshëm

136. Kur futeni në një termikë, ju duhet:

- a) të lëvizini në rreth në të njëjtin drejtim si edhe paragjajdi i cili tashmë ndodhet në atë termike

- b) mos të hyni, përveç nëse jeni në të njëjtën lartësi si edhe paraglajdi i cili tashmë ndodhet në atë termike
- c) të lëvizini në rreth në drejtim të kundërt nga paraglajdi i cili tashmë ndodhet në atë termike

137. Derisa fluturoni nga lartë-poshtë, paraglajdi juaj pëson një kolaps (collapse) në anën e majtë. Cili duhet të jetë reagimi i parë? (Lartësia juaj në këtë moment është 200ft/60m):

138. Për ta bërë një kthesë, çfarë duhet të bëni fillimisht?

139. Kur arrini në vendin e fluturimit, çfarë është gjëja e parë që ju duhet ta bëni?

140. Çfarë shkakton shtrëngimi kryqëzues (Cross bracing)?

141. Pse përdoret shtegu apo “figura 8”?

142. Çfarë duhet të merret parasysh para se të fillohet kthimi prej 360 gradë para një kodre?

143. Cila është mënyra më e mirë e afrimit për aterrim?

- a) në një fushë të ngushtë?

b) në një zonë të uljes pa pengesa?

144. Përshkruani rreziqet që mund t'i hasni kur fluturoni në afërsi të stuhisë?

145. Cili është problemi kryesor që ndërlidhet me përdorimin e trimerëve (trim tabs)?

146. Çfarë duhet të bëjë piloti kur të hyjë në hije të erës (wind shadow)?

147. Çfarë është thithja nga retë (cloud suck)?

Situatat e rrezikshme dhe procedurat emergjente

148. Për çfarë shërben parashuta emergjente?

149. Çfarë është qëllimi i elementeve të veçanta për reduktimin e goditjeve nga pesha (shock loads)?

150. Çfarë probleme mund të hasni kur niseni apo aterroni në terrenin e mbuluar me dëborë?

151. Turbulencat mund të hasen më së shpeshti:

- a) afër maleve
- b) në mesditë
- c) në hapësirë të rrafshët
- d) në rrjedhën e erës nga ndërtesat
- e) në të gjitha nga lartë

152. Cila frekuencë përdoret për komunikimin emergjent?

- a) 126.7 Mhz
- b) 124.8 Mhz
- c) 130.35 Mhz
- d) 121.5 Mhz

153. Helmetat nuk kërkohen për të fluturuar me paraglajd?

- a) e saktë
- b) e pasaktë

154. Cilat rreziqe ndërlidhen gjatë fluturimit në afërsi të reve të mëposhtme:

- a) Cumulonimbus

b) Orografike

155. Nëse gjatë fluturimit paraglajdi juaj pëson një kolaps në anën e majtë të krahut, cili duhet të jetë reagimi i parë? Lartësia juaj në moment është 200ft/60m?

156. Nëse jeni duke fluturuar me vargmal në anën e djathtë, kurse një pilot tjetër është duke fluturuar drejt jush, çfarë veprimi duhet të ndërmerri? Çfarë problemesh tjera duhet të keni parasysh?

157. Para sa ta bëni një kthesë, çfarë duhet të bëni së pari?

158. Kur arrini në vendin për fluturim, cila është gjëja e parë që ju duhet ta bëni?

159. Veshët e mëdhenj (big ears) - çfarë është dhe çfarë efekti ka në fluturim?

160. Ndryshimi i shtypjes 1milibar është i barabartë me sa shputa (feet)?

161. Kur mund të ndodhë rënia e përparme (front fall)?

162. Si mund ta shkaktojmë qëllimisht thyerjen e plotë të ngritjes (full stall)?

163. Cilat manovra nuk janë të miratuara si teknika për ulje të shpejtë?

Mjekësia e aviacionit dhe ndihma e parë

164. Gazrat më të rëndësishëm në procesin e shkëmbimit të gazrave në organizëm janë:

- a) Azoti (N_2) dhe Oksigjeni (O_2)
- b) Oksigjeni (O_2) dhe Dy-oksidi i Karbonit (CO_2)
- c) Heliumi (He) dhe Ozoni (O_3)

165. Cilat janë grupet kryesore të gjakut te njeriu?

166. Si quhet zvogëlimi i përmbajtjes së oksigjenit në ajrin atmosferik?

167. Zvogëlimi i përmbajtjes së oksigjenit në ajrin atmosferik është i shprehur:

- a) Gjatë rritjes së lartësisë mbidetare
- b) Gjatë zvogëlimit të lartësisë mbidetare
- c) Gjatë mos ndryshimit të lartësisë mbidetare
- d) Asnjëra nga përgjigjet e mësipërme

168. Sasia e gjakut në qarkullim te një person i rritur është:

- a) 2-3 l
- b) 5-6 l
- c) 3-4 l

169. Cila është mënyra më e shpejtë për ndaljen e përkohshme të gjakderdhjes nga plaga?

- a) Fashimi dhe/ose lidhja e plagës
- b) Komprimimi/shtypja me gishtërinj në vendin e gjakderdhjes
- c) Qepja kirurgjike e plagës
- d) Asnjëra nga përgjigjet e mësipërme

170. Frakturat/Thyerjet e eshtrave mund të jenë:

- a) Të mesme dhe të ndërmjetme
- b) Të hapura dhe të mbyllura
- c) Të vogla dhe të mëdha
- d) Asnjëra nga përgjigjet e mësipërme

171. Cilat janë shenjat vitale që duhet të kërkohen te një i aksidentuar në vendin e ngjarjes?

172. Goditja e rrufesë shkakton pasoja më të rrezikshme nëse:

- a) Shkarkimi elektrik kalon nëpër muskujt e skeletit
- b) Shkarkimi elektrik kalon nëpër muskulin e zemrës
- c) Shkarkimi elektrik kalon nëpër eshtra
- d) Asnjëra nga përgjigjet e mësipërme

173. Çka është pulsi?

174. Përshkruani disa nga pikat anatomike në trup, në të cilat më lehtë mund të preket pulsi arterial.

175. Çka nënkuptoni me imobilizim?

176. Gjatë vjelljes dhe barkqitjes më së shpeshti humben:

- a) Uji dhe lëngjet
- b) Elektrolitet
- c) Gjaku dhe produktet e tij
- d) Asnjëra nga përgjigjet e mësipërme

177. Sipas shtrirjes dhe thellësisë së djegies, djegiet klasifikohen në:



- a) Dy shkallë
- b) Katër shkallë
- c) Tre shkallë
- d) Asnjë nga përgjigjet e mësipërme


178. Infeksionet e rënda të veshit të mesëm dhe të brendshëm mund të rezultojnë me:

- a) Dëmtim të dëgjimit
- b) Çrregullim të drejtpeshimit
- c) Marramendje dhe humbje të orientimit në hapësirë
- d) Të gjitha përgjigjet e mësipërme

179. Kufiri i sipërm i lejuar i nivelit të ndotjes akustike (zhurmës) është:
- 58 dB
 - 85 dB
 - 120 dB
 - mbi 120 dB
180. Defekti në dallimin/njohjen e ngjyrave te personeli i aviacionit:
- E përjashton kandidatin nga fluturimi
 - Nuk e përjashton kandidatin nga fluturimi
 - E lejon të ushtrojë fluturimin me disa kufizime
 - Asnjëra nga përgjigjet e mësipërme
181. Gjatë fluturimit, qarkullimi i gjakut përqendrohet:
- Në pjesën e poshtme të trupit, për shkak të efektit të gravitetit
 - Në pjesën e sipërme të trupit, për shkak se gjaku qarkullon më tepër në tru
 - Në gjymtyrët e trupit
 - Asnjëra nga përgjigjet e mësipërme
182. Në kushte të hipoksisë frekuenca/shpeshtësia e frymëmarrjes:
- Nuk ndryshon
 - Zvogëlohet
 - Rritet
 - Asnjëra nga përgjigjet e mësipërme
183. Nëse i aksidentuari ka humbur sasi të madhe të gjakut, parametrat e tij/saj vitalë do të dukeshin si në vijim:
- Shtypja e gjakut zbret, frymëmarrja nuk ndryshon, puls i preket më shumë
 - Shtypja e gjakut rritet, frymëmarrja shpeshtohet, puls i nuk ndryshon
 - Shtypja e gjakut zbret, puls i preket me vështirësi, vetëdija turbullohet, frymëmarrja shpeshtohet
 - Asnjëra nga përgjigjet e mësipërme
184. Nëse ju jeni 41 vjeçar, për sa kohë do të jetë e vlefshme Certifikata e juaj mjekësore e Klasës 2?
- 12 muaj
 - 36 muaj
 - 24 muaj
185. Sa është vlera fiziologjike e shtypjes së gjakut?
- 90/60 mmHg
 - 130/90 mmHg
 - 120/80 mmHg

Lista e përgjigjeve të sakta

1	c)
2	b)
3	c)
4	d)
5	<p>Këndi i sulmit është këndi ndërmjet linjës së kordës të profilit ajror (airfoil) dhe vektorit që përfaqëson lëvizjen relative në mes të trupit dhe fluidit nëpër të cilin është duke lëvizur.</p> 
6	e)
7	a)
8	a)
9	a)
10	
11	Tërheqja nga gravitacioni ofron forcën e nevojshme për lëvizjen e paragllajdit në ajër, pasi që një pjesë e vektorit të peshës së paragllajdit është e drejtuar përpara.
12	<p>Krahu i paragllajdit mban formën e tij aerodinamike nga shtypja e brendshme e cila rezulton nga lëvizja përpara.</p> <p>Krahu i paragllajdit përbëhet nga dy shtresa të pëlhurës të cilat janë të ndërlidhura me material mbështetës të brendshëm, në mënyrë të tillë që formojnë një radhë të celulave. Përderisa celulat janë hapur vetëm në tehun para, ajri që hynë e mban krahun të fryrë, duke ruajtur formën e tij.</p>
13	Kushtet termike jo-stabile
14	a)
15	a)
16	a)
17	b)
18	a)
19	c)
20	a)

21	<p>a) Rrëshqitja proporcionale (glide ratio): Distanca horizontale përpjesëtuar me ndryshimin në lartësi. Një tjetër mënyrë për të menduar për këtë është të pyesni, se sa larg ka udhëtuar një paraglajd para, për çdo metër të lartësisë së humbur?</p> <p>b) Shkalla e rënies (sink rate): Shkalla e uljes në lartësi është e referuar si shkalla e uljes apo shkalla e rënies. Rënia në lartësi korrespondon me një shkallë negative të ngritjes.</p> <p>c) Ngarkesa e krahut (wing loading): Ngarkesa e krahut është e shprehur në kg/lbs për m/ft në katror dhe përfitohet duke përpjesëtuar peshën totale të mjetit ajror në kg / lbs me sipërfaqen e krahut në m/ft katror.</p>
22	
23	<p>a) keni 10 kph erë ballore 10 Km/h</p> <p>b) keni 20 kph erë nga mbrapa 40 Km/h</p> <p>c) keni 30 kph erë ballore -10 Km/h</p>
24	<p>a) Ngarkim i lehtë i krahut (nën specifikimet e prodhuesit) Operimi me ngarkim të lehtë të krahut: kupola (canopy) është e prirë për tundje prapa nga një erë jostabile (gust); Poashtu e prirë edhe për të dalë nga pozita normale dhe të shkaktojë thyerjen e forcës ngritëse (stall). Dalja (recovery) nga efekti i “parashutizmit” është edhe më pak i sigurtë, sepse ka forcë shtytëse te vogël. Kupola (canopy) nuk do të ketë tension të mirë dhe mund të deformohet lehtë.</p> <p>b) Ngarkim i rëndë i krahut (mbi specifikimet e prodhuesit) Operimi me ngarkim të rëndë të krahut: Shpejtësia dhe energjia kinetike me e madhe mund të rezultojë në thyerje të mprehta me amplitudë të lartë të lëvizjes cirkulare/spirale (gyrations) pasi që tehu i përparmë është thyer/kthyer (tuck). Kupola (canopy) mund të lëvizë përpara në mënyrë më agresive dhe pilotët duhet të reagojnë me shpejtësi dhe agresivitet.</p>
25	c)
26	a)
27	a)
28	<p>1 matja (a): b</p> <p>2 matja (b): a</p> <p>3 matja (c): d</p> <p>4 pika (d): c</p> <p>5 pika (e): f</p> <p>6 këndi i sulmit (i): e</p>
29	e)
30	a)
31	c)
32	<p>a. Pika e stagnimit apo pika ndërprerjes (Breakpoint) 1</p> <p>b. Qendra e shtytjes 3</p> <p>c. Pika e paqëndrueshmërisë (stall) 2</p>

33	<p>1. Ngitja është zvogëluar dhe rezistenca është rritur. Pika e paqëndrueshmërisë (stall) (X) shfaqet në sipërfaqen e sipërme. Pas kësaj pike rezulton turbulenca në një komponent të rënies së presionit te poshtë, i cili zëvendëson presion negativ. b</p> <p>2. Efekti optimal (10-15 °), me një ngritje të konsiderueshme dhe rezistencë të reduktuar përmes presionit të ulët në sipërfaqen e sipërme dhe presionit konsistente dhe efektive në sipërfaqen e poshtme. a</p> <p>3 Ndërkohë që rezistenca vazhdon, presioni negativ vazhdon në sipërfaqen e sipërme, dhe në një masë më të vogël në sipërfaqe e poshtme. Këto forca e kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe rezultojnë në një ngritje shumë të vogël. d</p> <p>4. Rrjedha e ajrit shkakton sipërfaqe e poshtme që të ketë presion negativ, dhe presion pozitiv mbi sipërfaqen e sipërme. Me të dy efektet duke vepruar teposhtë, profili tani ka një ngritje negative. c</p>
34	a)
35	<p>a. 10 ° Efikasiteti maksimal dhe këndi më i mirë i planerimit</p> <p>b. 20 ° Forcë ngritëse maksimale (lift), por me efekt shoqërues të rezistencës (drag) relativisht të lartë.</p> <p>c. 25 ° Forca ngritëse (lift) zhduket dhe krahu pëson thyej te forcës ngritëse (stalls)</p>
36	<p>a. 10 ° 3</p> <p>b. 20 ° 1</p> <p>c. 25 ° 2</p>
37	Ngritja direkt në erë nënkupton, arritjen e shpejtësisë ajrore (air speed) më shpejt e cila është e rëndësishme për forcën ngritëse të mjetit ajror nga toka. Era ballore (headwind) gjithashtu ndalon mjetin ajror me shpejt në rast të anulimit të ngritjes apo gjatë aterimit.
38	<p>a) Përshkrimi: Situatë e cila krahu nuk ka rrjedhë të ajrit të mjaftueshme përmbi të gjeneroj force ngritëse (lift) te mjaftueshëm qe te mbajë mjetin ajror ne ajër.</p> <p>b) Rreziqet: Gjatë fluturimit te zakonshëm, thyerja e forcës ngritëse (stall), zakonisht ndodhë para aterimit dhe pas ngritjes, kur mjeti ajror ka shpejtësi të vogël. Në këto dy situata mjeti ajror është shumë afër tokës dhe kërkon një veprim të menjëhershëm të pilotit për të ju shmangur përplasjes.</p>
39	Gjatë thyerjes se forcës ngritëse (stall) të plotë, paragllajdi ndalon së fluturuari dhe humbet formën, por gjatë thyerjes se forcës ngritëse (stall) parashutale, paragllajdi është i hapur në tërësi, (jo i mbyllur apo në kolaps), mirëpo nuk fluturon më.
40	<p>a) lëvizjet e kontrollit dhe parimet: Paragllajdet kontrollohen nga një palë e linjave drejtuese apo frenuese. Gjatë tërheqjes së linjës frenuese të majtë, ju ktheheni majtas. Gjatë tërheqjes së dy linjave frenuese ju do të ngadalësoni. Përveç kësaj, duke lëvizur trupin tuaj, ju shtoni lëvizje kontrolli shtesë.</p> <p>b) Kontrolli i shpejtësisë dhe kthesat (turning): Paragllajdet kanë një shirit të shpejtësisë (speedbar) i cili kur shtyhet para me këmbë, tërheq tehun para të krahut, duke rritur shpejtësinë e fluturimit. “Big Ears” është një metodë kur</p>

	<p>piloti tërheq brenda skajet e krahut, në mënyrë që të zvogëlojë rezistencën dhe shpejton rënien. Paragllajdet poashtu kanë kontroll të frenave në dy duart të cilët janë jashtëzakonisht të dobishëm për të ndryshuar shpejtësinë dhe drejtimin e fluturimit. Frenat janë të rëndësishëm për sigurinë e pilotit, mirëpo edhe në rast të mosfunksionimit zgjatësit (risers) që janë të lidhur me pjesën e pasme të krahut mund të shfrytëzohen të drejtojnë apo dhe ngadalësojnë fluturimin.</p> <p>c) Përdorimi i frenave kundrejt ndryshimit të peshës: Kontrollet të cilët ju i mbani në dorën tuaj lidhen në teahun prapa (trailing edge) të krahut. Me tërheqjen e kontrolleve në të djathtë njëherësh lehtësimin e presionit në të majtë ju do të ktheni djathtas. Kjo bën që ana e djathtë e krahut të fluturoj më ngadalë dhe ana e majtë më shpejtë. Gjithashtu ju mund të zhvendoseni peshën tuaj për të ndihmuar në drejtimin e paragllajdit.</p>
41	<p>a) Rrotullimi rreth boshtit vertikal (spin) Rrotullimi rreth boshtit vertikal (spin) në paragllajd, ndodh kur njëra anë e krahut ka arritur thyerjen e forcës ngritëse (stall), me ç 'rast krahu rrotullohet në boshtin ndërmjet pilotit dhe paragllajdit.</p> <p>b) Spirale: Është një konfigurim në të cilin paragllajdi futet në kthim të ashpër pjerrtas (steep bank). Shtegu i paragllajdit në këtë rast mund të përshkruhet si kaçavidë.</p>
42	Pajisjet dhe paragllajdi ruhen në vend të thatë dhe të errët në temperaturë mesatare.
43	Verifikimi teknik duhet të bëhet brenda dy (2) viteve për paragllajdët, apo siç përcaktohet ndryshe nga prodhuesi.
44	Nëse ju kenë aterruar në ujë të kripur, ju duhet të shpërlani të gjitha pajisjet tuaja në ujë të pastër. Nëse nuk e bëni këtë shumë komponente do të dëmtohen, pasi kristalet e ujit të kripur mbeten dhe ato janë më të rënda se sa fibrat Kevlar që përdoren në linjat e paragllajdit, duke e konsumuar/grisur materialin.
45	Personi i autorizuar/trajnuar për paketim, dhe afati kohor përcaktohet nga prodhuesi.
46	Krahu i paragllajdit ka formë elipsoide, kur shihet nga lart dhe ka gjysmë-krah nga ana e djathtë dhe e majtë. Krahu përbëhet nga celulat, të ndara nga muret. Pjesa e përparme e krahut quhet pjesa kryesore (leading edge) dhe këtu është vendi ku celulat janë të vendosura. Kjo është pjesa ky ajri hyn dhe krahu fryhet nga ajër. Pjesa e pasme e krahut quhet trailing edge. Pjesa e jashtme e çdo gjysmë-krahu quhet vesh, e cila përfundon me majën e krahut. Distanca në mes të majës së krahut quhet hapësira e krahut.
47	Paragllajdëve u jepen klasifikimet EN ose LTF. Klasifikimi LTF përfshinë klasat 1, 1-2, 2, 2-3, dhe 3. Klasifikimi EN përfshinë klasat A, B, C, ose D.
48	Shtojcën e krahut; lidhjen me parashutën emergjente; si ta instaloni parashutën emergjente; lidhjen e pajisjeve tërheqëse; shtojcën e pajisjeve (përshpejtues, çakëll, etj); detajet në lidhje me qëllimin dhe funksionimin e çdo shtojce të ofruar nga prodhuesi; si të rregullohet dhe të përshtatet rrypi përpara ngritjes, pas ngritjes dhe uljes; frekuenca e rekomanduar e inspektimeve nga prodhuesi; pesha maksimale e pilotit (masa); udhëzimet e mirëmbajtjes
49	Litari është pjesë aerodinamike e një paragllajdi, e përbërë nga pëlhura dhe elemente të tjera jo të ngurta. Elemente të ngurta mund të përdoren për të drejtuar linjat e frenave në mes të pikës së lidhjes dhe pikës më të lartë të degëzimit.
50	Varësja e paragllajdit shpërndan peshën e pilot përgjatë sipërfaqes së krahut; i jep formë krahut; vendos balancën në këndin e sulmit në seksione të ndryshme të krahut (pjesën qendrore, veshët); dhe gjatë fluturimit mundëson kontrollin e këndit të sulmit.
51	Varësja përbëhet nga linjat (lines), zgjatësit (risers) dhe karabinët (carabineers).
52	Rripi i paragllajdit mbulon trupin e pilotit dhe transferon peshën e tij në krah përmes karabinëve, zgjatësve dhe linjave
53	Faktorët mekanik që ndikojnë në dëmtimin e forcës dhe strukturës materiale të paragllajdit

	janë:
	<ul style="list-style-type: none"> • ngarkesat normale dhe ekstreme gjatë fluturimit; • fërkimet në tokë gjatë ngritjes, uljes, palosjes dhe shpalosjes; • deformitetet dhe fërkime gjatë palosjes dhe transportimit; • kapja dhe ngjitja e degëve, shkurreve, gjembave, rrënjëve, gurëve, shkëmbinjve dhe të tjera, të cilat së bashku me shkeljen në vela dhe linja mund të shkaktojnë grisje dhe dëme.
54	Distanca në mes pjesës së përparme dhe të pasme të çdo profili quhet kordë.
55	Karakteristikat kryesore të një profili janë gjatësia e kordës, trashësia maksimale e profilin dhe pozicioni i tij.
56	Visual Flight Rules/Fluturimi sipas rregullave vizuale
57	Visual meteorological condition/Kushtet vizuale meteorologjike
58	a)
59	c)
60	Troposferë apo niveli i ulët i atmosferës
61	b)
62	d)
63	d)
64	b)
65	b)
66	a)
67	<ol style="list-style-type: none"> a. Drejtimi dhe shpejtësia e erës b. Pamja horizontale dhe vizuale c. Temperatura e ajrit d. Parashikimi i motit
68	Drejtimi i erës nga 270 gradë me shpejtësi 5 nyje (knots)
69	a)
70	b)
71	b)
72	c)
73	c)
74	a)
75	<ol style="list-style-type: none"> a) Lëvizja e drejtimit të gjetheve, drunjëve b) Drejtimi i tymit nga oxhaqet
76	Me shprehjen front i ftohtë nënkuptohet një masë e ajrit të ftohtë duke kaluar dhe zëvendësuar një masë të ajrit të ngrohtë. Në përgjithësi frontet e ftohtëta lëvizin nga veriperëndimi në juglindje. Gjatë kalimit të frontit të ftohtë, temperaturat mund të ulen për më tepër se 15°C brenda një ore.
77	Me shprehjen front i nxehtë nënkuptohet një masë e ajrit të ngrohtë duke kaluar dhe zëvendësuar një masë të ajrit të ftohtë. Në përgjithësi frontet e ngrohta lëvizin nga jugperëndimi në verilindje. Kur një front i ngrohtë kalon, ajri bëhet me i ngrohtë dhe me i lagësht se më parë.
78	Mjegulla është avulli i ujit i kondensuar në shtresat e ulëta të ajrit. Mjegull është mbetja pezull e pikave të vogla të ujit ku shikimi horizontal bie nën 1km.
79	Era është një dukuri natyrore që përbëhet nga lëvizja e rregullt, pothuajse e rrafshët, e masës ajrore të shkakuar nga trysnia mes dy pikave të atmosferës. Era është një përzierje e një rryme ajri të ngrohtë dhe një rryme ajri të ftohtë.
80	Meteorologjia është shkencë, e cila studion të gjitha dukuritë fizike në mbështjellësin ajror rreth tokës, respektivisht atmosferës. Përveç kësaj, meteorologjia studion edhe ca dukuri fizike, të cilat zhvillohen në vetë sipërfaqen e tokës dhe në shtresat e sipërme të tokës.

81	METAR është një format i raportimit të informatave mbi motin. Raporti i motit (METAR) kryesisht përdoret nga pilotët para një fluturimi. METAR po ashtu ndihmon në parashikimin e motit. METAR zakonisht përmban të dhënat për temperaturën, pika e vesës, shpejtësia dhe drejtimi i erës, reshjet, mbulimi i qiellit me re dhe lartësia e tyre, dukshmëria, dhe shtypjen e ajrit.
82	a)
83	Rregullorja Nr. 1/2012 për Kushtet dhe mënyrën e përdorimit të deltaplanëve dhe paraglajdëve
84	Aeronautical Information Publication
85	Visual Meteorological Conditions
86	Çdo mjet i cili lëvizë në atmosferë nga reaksioni i ajrit përveç reaksioneve të ajrit kundrejt sipërfaqes së tokës.
87	Nënkupton aerodromin i cili nuk ka pistë me sipërfaqe të fortë dhe i cili nuk shfrytëzohet për fluturimet ndërkombëtare.
88	Nënkupton kohën e përgjithshme nga momenti i lëvizjes së parë të mjetit ajror për qëllim të ngritjes deri në momentin kur ai përfundimisht ndalet në fund të fluturimit.
89	Nënkupton gënjatërin e varur pa konstruksion themelor të ngurtë.
90	Po
91	Certifikata e përputhshmërisë
92	Prodhuesi apo personi juridik/fizik i pranuar nga AAC-ë për të kryer verifikimin teknik.
93	Dy kopje
94	a), b), c), d), e), f)
95	Jo
96	a), b), c), d)
97	Paraglajdët mund të fluturonë në lartësi jo më të vogël se 50 metra (150 shputa).
98	<ul style="list-style-type: none"> a) mbi zonat e deklaruara të ndaluara, b) në kushte të pafavorshme të motit, c) në re, d) në largësinë vertikale prej më pak se 150 m (500 shputa) nën bazën e reve, e) nën ura dhe objekte të ngjashme, linja elektrike të transmisionit dhe antena.
99	<ul style="list-style-type: none"> a) kur dy paraglajdë fluturojnë në të njëjtën lartësi apo afër së njëjtës lartësi me njëri tjetrin, të dy paraglajdët duhet të kthehen në anën e djathtë, ashtu që distanca në mes tyre të jetë së paku 50 metra; b) kur dy paraglajdë fluturojnë në të njëjtën lartësi apo afër së njëjtës lartësi me njëri tjetrin dhe me pjerrtësi malore anash tyre, përparësi ka ai me pjerrtësinë malore në anën e tij të djathtë. Paraglajdi me pjerrtësinë malore në anën e tij të majtë duhet të kthehet në të djathtë për të siguruar distancën e nevojshme ndërmjet tyre prej së paku 50 metrave.
100	<ul style="list-style-type: none"> a) paraglajdi më i ngadalshëm ka përparësi; b) kur paraglajdi që fluturon më shpejtësi më të madhe ajrore, takon, për afërsisht në të njëjtën lartësi, paraglajdin tjetër që fluturon në të njëjtin drejtim me shpejtësi më të vogël ajrore, ai mund ta tejkalojë atë duke u kthyer djathtas; c) paraglajdi nuk duhet të tejkalojë paraglajdin tjetër afër pjerrtësive malore nëse ajo ndodhet në anën e djathtë në raport me drejtimin e fluturimit; d) nëse pjerrtësia malore është në anën e majtë në raport me drejtimin e fluturimit, tejkalimi lejohet, me kusht që paraglajdi që fluturon me shpejtësi më të madhe ajrore e tejkalon paraglajdin me shpejtësi më të ultë ajrore nga ana e djathtë.
101	<ul style="list-style-type: none"> a) me kryqëzim të vijave të fluturimit nënkuptohej vija e fluturimit të një paraglajdi që kryqëzohet me vijën e fluturimit të një paraglajdi tjetër në kënd prej 70 deri në 160 shkallëve; b) kur ndodhë kryqëzimi i vijave të fluturimit të paraglajdëve që fluturojnë

	përafërsisht në të njëjtën lartësi, përparësi ka paraglajdi që vjen nga ana e djathtë e paraglajdit tjetër. Paraglajdi që nuk ka përparësi duhet të kthehet në mënyrë që t'ia lëshojë rrugën atij që ka përparësi.
102	a) kur disa paraglajdë, fluturojnë në të njëjtën shtyllë termike, përparësi ka ai që ka filluar rrotullimin i pari; b) paraglajdët duhet të rrotullohen në të njëjtin drejtim (majtas apo djathtas).
103	a) kur disa paraglajdë janë duke aterruar, në një interval të shkurtër kohor, në të njëjtin vend për aterrim, përparësi ka ai që gjendet në lartësinë më të ultë, përveç nëse një paraglajd tjetër është: i) në fazën finale të aterimit, apo ii) në rrezik. b) në të gjitha situatat tjera gjatë fluturimit, duhet të aplikohen dispozitat e rregullave në ajër (rules of the air) ashtu siç janë paraparë në Ligjin nr. 03/1-051 për aviacionin civil
104	a) helmata; b) parashuta për shpëtim; c) radio-komunikimi; d) matësi i lartësisë (altimeter)
105	Fluturimi akrobatik lejohet vetëm nëse paraglajdi është i dizajnuar për fluturime të tilla, apo në përputhje me udhëzimet e prodhuesit për llojin e veçantë të paraglajdit, dhe duhet të kryhet mbi lartësinë minimale të sigurisë.
106	Para fluturimit të parë me instruktor të autorizuar të fluturimit, piloti nxënës duhet të jetë së paku 15 vjeç.
107	Kandidati që kërkon licencën e pilotit për paraglajd duhet t'i ketë së paku 10 orë fluturimi të përgjithshëm si pilot nxënës në paraglajd, duke përfshirë këtu së paku: a) 60 fluturime të suksesshme, secili nga ta me kohëzgjatje më të madhe se 5 minuta, nga të cilët më shumë se 30 fluturime mund të bëhen në mënyra të ndryshme të ngritjes nga mënyra në të cilën kandidati do t'i nënshtrohet provimit, nëse organizata e aprovuar e kryen trajnimin i cili përmban mënyra të ndryshme të ngritjes, b) 3 fluturime nga të cilët secili me kohëzgjatje prej së paku 2 orëve.
108	Para se t'i nënshtrohet provimit për marrjen e licencës së pilotit të paraglajdit, kandidati duhet të jetë së paku 16 vjeç.
109	a), b), c), d), e), f), g)
110	Kandidati duhet të përsërisë tërë provimin teorik nëse pas tentimit të katërt nuk e ka kaluar ndonjërin lëndë, apo nëse ka skaduar periudha prej 18 muajve kalendarik prej se aplikuesi ka aplikuar për herë të parë për provim.
111	Suksesi i pjesës teorike të provimit është i vlefshëm për periudhën prej 24 muajve nga data e kryerjes me sukses të tërë provimit teorik. Nëse gjatë kësaj periudhe kandidati nuk i nënshtrohet provimit praktik (fluturimit), atëherë ai/ajo duhet ta përsërisë provimi teorik në tërësinë e tij.
112	Nëse gjatë dy tentimeve paraprake kandidati nuk i ka kaluar me sukses të gjitha seksionet e provimit praktik (fluturimit), ai/ajo dërgohet për trajnim praktik (fluturim) shtesë, sipas rekomandimeve me shkrim të ekzaminuesit.
113	Mbajtësi i licencës së pilotit të paraglajdit gjithmonë duhet të mbajë me vete licencën e tij/saj të vlefshme dhe certifikatën e vlefshme mjekësore kur ushtron privilegjet e lejuara me licencë.
114	Licencat e pilotëve të paraglajdit lëshohen pa ndonjë datë të skadimit.

115	Piloti i deltaplanit apo paraglajdit mund të marrë autorizimet në vijim: Autorizimin »I«: instruktor i fluturimit i deltaplanit/paraglajdit, Autorizimin »D«: pilot tandem i deltaplanit/paraglajdit, Autorizimin »T«: pilot testues i deltaplanit/paraglajdit, Autorizimin »A«: fluturim akrobatik me deltaplan/paraglajd.
116	Periudha e vlefshmërisë e secilit autorizim është katër (4) vjet.
117	Para se t'i nënshtrohet provimit për marrjen e autorizimit të instruktorit të fluturimit, aplikuesi duhet të jetë së paku 18 vjeç dhe duhet të jetë bartës i licencës së pilotit të paraglajdit për së paku dy (2) vite, dhe duhet të ketë përfunduar së paku 100 orë kohë të fluturimit dhe të ketë kryer së paku dhjetë (10) fluturime të ndryshme në paraglajd përkatësisht, nga të cilët dy (2) fluturime duhet të jenë më të gjata së 50 km.
118	Para se t'i nënshtrohet provimit për marrjen e autorizimit për fluturim akrobatik, aplikuesi duhet të jetë së paku 18 vjeç, duhet të ketë licencën e pilotit të paraglajdit për së paku dy (2) vite dhe të ketë përfunduar një kohë të përgjithshme të fluturimit prej së paku 100 orëve të fluturimit në paraglajd.
119	Para se t'i nënshtrohet provimit për marrjen e autorizimit për pilot tandem, aplikuesi duhet të jetë së paku 18 vjeç, duhet të posedojë licencën e pilotit të paraglajdit për së paku dy (2) vite dhe duhet të ketë përfunduar një kohë të përgjithshme të fluturimit prej së paku 100 orëve të fluturimit në paraglajd, dhe të ketë kryer së paku dhjetë fluturime të ndryshme në paraglajd.
120	Para se t'i nënshtrohet provimit për marrjen e autorizimit për pilot testues, aplikuesi duhet të jetë së paku 18 vjeç, duhet të posedojë licencën e pilotit të paraglajdit për së paku dy vite dhe duhet të ketë përfunduar një kohë të përgjithshme të fluturimit prej së paku 200 orëve të fluturimit në paraglajd, nga të cilat së paku 100 orë të fluturimit në paraglajd i cili është i dedikuar për gara, dhe të ketë kryer së paku 20 orë të fluturimit në secilin nga pesë llojet e ndryshme të paraglajdëve.
121	Para lëshimit të licencës së Republikës së Kosovës, bartësi i licencës së pilotit të paraglajdit të lëshuar në shtetin e huaj duhet t'i plotësojë kërkesat si në vijim: a) të demonstrojë nivelin e njohurisë teorike të rregullave dhe legjislacionit në fuqi, b) të dorëzojë verifikimin e aftësisë së fluturimit të mbajtur nga ekzaminuesi i autorizuar, c) të posedojë certifikatën e vlefshme të gjendjes shëndetësore, d) të ketë përfunduar së paku 30 orë kohë të përgjithshme të fluturimit në paraglajd.
122	Pjesa teorike përfundon me provim me shkrim që përmban 50 detyra dhe norma për të kaluar provimin duhet të jetë së paku 75% saktësi.
123	g)
124	g)
125	a)
126	Kjo do të jetë përshtatje (trim) me pak ose aspak presion ndaj frenave
127	Ai i cili ka vargmalin në anën e djathtë të saj/tij.
128	Sigurohuni që ju keni lartësi të mjaftueshme për të shmangur erën në anën e mbrojtur nga era dhe si një rregull e pashkruar të jeni dy herë më lartë se lartësia e vargmalit që rrethon vendin para se të fluturoni në drejtimin e erës.
129	<ul style="list-style-type: none"> • Ajër i qetë . Tymi ngrihet vertikalisht. • Rritje e pirgjeve të tymit. • Treguesi i erës është joaktiv. • Gjethet shushurisin. • Mund të ndjeni erën në fytyrën tuaj. • Treguesi i erës është ende joaktiv. • Gjethet dhe degëzat lëvizin. • Flamujt e lehtë të erës fillojnë të zgjaten.

	<ul style="list-style-type: none"> • Degët e holla lëvizin. • Era mund të ngrejë pluhur dhe letra. • Pemët të vogla tunden. • Degë të mëdha të pemëve lëvizin. • Teli i ekspozuar mund të fërshëllejë. • Pemët e mëdha tunden. • Rezistenca ndjehet kur ecën.
130	Piloti me vargmalin në anën e djathtë ka të drejtën e rrugës. Pra, piloti me vargmalin në anën e majtë duhet të marrë veprim e të largohet nga drejtimi. Keni kujdes për turbulencën nga piloti përgjatë kalimit.
131	a)
132	b)
133	c)
134	b)
135	a)
136	a)
137	Krahu ka pësuar kolaps (collapse) në anën e majtë- së pari të mbahet kursi/drejtimi, tani vëni peshën tuaj mbi anën fluturuese të krahut dhe duke pompuar frenat me ritme të gjata dhe të forta nxjerrni krahun e paraglajdit nga kolapsi.
138	Gjithmonë së pari shikoni përreth!
139	Monitoroni kushtet atmosferike për aq kohë sa duhet, për tu siguruar për fluturim; në qoftë se nuk jeni të sigurt mos fluturoni.
140	Shtrengimi kryqëzues (Cross bracing) ofron më shumë stabilitet në krahun dhe redukton ndjenjën e paraglajdit - mund të lihet në funksion dhe zbatohet në kushte atmosferike të vështira, shumica paraglidereve janë testuar dhe certifikuar me këtë.
141	Shtegu apo "Figura 8" përdoret gjatë afrimit për ulje për të qëndruar në drejtimin e erës (downwind) nga zona e uljes. Ky shteg lejon pilotin të qëndroj në drejtimin e erës (downwind) dhe stacionar mbi një zonë në afërsi të zonës së uljes.
142	Shiko për paraglajderë të tjerë para se të bëni ndonjë kthesë. Sigurohuni për lartësi të mjaftueshme dhe distancë prej kodrës. Mos harroni që rrezja e kthimit është më e madhe në drejtimin e erës.
143	a) Figura 8 të përdoret për afrim dhe aterrim në fushë të ngushtë; b) Afrimi standard i paraglajdit. Kjo përdoret në drejtim të erës, bazës dhe finales (downwind leg, base and final).
144	- thithje nga retë - turbulencë - vetëtimë
145	- Kolapson për shkak të lënies në funksion të trimerëve duke qenë ende në turbulencë. - Mund të harrojmë se ato janë në funksion ose mund të lëshojmë ose ndalim nga funksionimi në mënyrë të pabarabartë. - Mund të jetë e nevojshme që të lirohen kontrollet për të lënë trimerët jashtë funksionimit gjatë fluturimit.
146	Të jetë i kujdesshëm nga turbulencat. Të fluturojë me pak frenim dhe të jenë të gatshëm për të reaguar ndaj ndonjë turbulencë.
147	Retë krijohen nga termalet, ato gjithashtu prodhojnë ngritje (lift) pasi që rritja e kondensimit gjeneron nxehtësi dhe jostabilitet brenda resë dhe përshejton ngritjen. Kjo ngritje quhet "thithje nga retë".
148	Parashuta emergjente është një pajisje emergjente me qëllim të ngadalësimit të zbritjes së pilotit të paraglajderit në rast të një incidenti në fluturim, e cila është hapet nga piloti në mënyrë manuale dhe të qëllimshme. Kjo parashutë mund të jetë e manovrueshme ose e

	pamanovrueshme.
149	Çdo komponent i veçantë i vendosur brenda sistemit të parashutës për të reduktuar goditjet e forcave fillestare në pilotin dhe parashutën në hapjet gjatë shpejtësisë së lartë. Nëse janë të vendosura ato duhet të identifikohen në mënyrë të qartë, me etiketë dhe ngjyrë, dhe udhëzimet e mirëmbajtjes (dhe zëvendësimit) të përfshihen në manualin e përdoruesit.
150	Nëse bora është e thellë, atëherë do të jetë e vështirë për të vrapuar (lëshuar/nisur) dhe do të ketë ulje të rrezikshme sepse ju do të ndaleni shpejt. Nëse bora është e ngjirë/akullt, ose e ngjeshur mund të jetë shumë e rrëshqitshme dhe po aq e rrezikshme.
151	e)
152	d)
153	b)
154	a) Cumulonimbus Në afërsi të reve ngritja termike papritmas mund të behet shumë e fortë, një fenomen i njohur si thithje e reve (cloud suck). Shumë pilotë kanë gjetur veten duke luftuar për të qëndruar jashtë reve. b) Orografike Shkaktohen nga ngritja në terren që detyron ajrin të ngritet përpjetë (ngritje orografik (Orographic Lift)). Këto stuhi formohen kur rrjedha e përgjithshme e ajrit me lagështi të paqëndrueshme kalon mbi terrenin më të lartë, si një varg malë. Prania e këtyre reve është e rëndësishme në atë që ato mund të jenë të shoqëruara me turbulenca të rrezikshme. Format e reve orografik të rëndësishme janë retë rotor (rotor cloud), reja kapak (cap cloud), dhe retë lentikulare (lenticular clouds).
155	Nëse krahu i majtë kolapson, gjëja e pare që duhet të bëni është të mbani kursin/drejtimin tuaj duke vendosur peshën tuaj mbi anën funksionale/ fluturuese të krahut dhe dhe shkundni krahun me shtypje të forta të frenave.
156	Ju duhet të mbani drejtimin/kursin tuaj pasiqë piloti me vargmal në të djathtë ka të drejtën e rrugës. Keni kujdes për ndonjë turbulencë nga piloti që kalon.
157	Të ktheheni, duke shikuar për ndonjë pengesë së pari.
158	Të monitorohen kushtet atmosferike për aq kohë sa të jetë e mundur, në qoftë se nuk jeni të sigurt për fluturim për shkak të kushteve meteorologjike mos fluturoni.
159	Veshët e mëdhenj aplikohet kur ju dëshironi të humbni lartësi, nuk është metodë për ulje rapide, duke rritur rezistencën ndërsa shpejtësia ulet.
160	30ft
161	Gjatë fluturimit, rënia e përparme mund të ndodhë gjatë largimit nga një termale e fortë, me rreth +6 apo +7 m/s në thelb dhe - 4 ose -5 m/s jashtë; ose mund të shkaktohet nga një erë e fortë (nëse fluturohet në anën nga fryn era); ose duke shtyrë shumë sistemin e shpejtësisë në ajër me turbulence; apo duke fluturuar në vazhden e një paragllajdi tjetër.
162	Ndalimi i plotë është një manovrim që mund të shkaktohet qëllimisht nga veprimet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> • duke ngadalësuar dhe tërhequr litarin me të dy frenat, tërhiqen në mënyrë të butë teposhtë në mënyrë simetrike me rreth 70 % të forcës; • duke tërhequr teposhtë të dy frenat dhe në mënyrë simetrike me rreth 70 % të forcës; • duke mbajtur frenat teposhtë simetrikisht me 100% të forcës për së paku 4 sekonda.
163	Manovrat e mëposhtme nuk janë të miratuara si teknika për ulje të shpejtë : <ul style="list-style-type: none"> • ndalimin asimetric, • rrotullim negativ, • rrotullim me veshë të mëdhenj, • rrotullim me lëvizje.
164	b)

165	Grupet kryesore te gjakut të njeriut janë: O, A, B, dhe AB
166	Zvogëlimi i përmbajtjes së oksigjenit në ajrin atmosferik quhet hipoksi ipobarike
167	a)
168	b)
169	b)
170	b)
171	Gjendja/Shkalla e vetëdijes, frymëmarrja/kalueshmëria e rrugëve të ajrit dhe të rrahurat e zemrës
172	b)
173	Pulsi është përhapja e valëve goditëse të të rrahurave të zemrës, nëpër muret e enëve të gjakut, nga zemra në qendër, deri në enët e gjakut në periferi
174	Në nyjen e shuplakës, në pjesën anësore të qafës, në gropën e pasgjurit, nën sqetull
175	Imobilizimi është një metodë e kufizimit të lëvizjeve të një gjymtyre apo pjese tjetër të trupit, që ndihmon në parandalimin e mëtejshëm të dëmtimeve gjatë transportit të të lënduarit, nga vendi i ngjarjes, deri në trajtim më të specializuar shëndetësor
176	Përgjigja është a) dhe b)
177	Përgjigja është b) dhe c)
178	d)
179	b)
180	Përgjigja b) dhe c)
181	As njëra nga të sipërpërmendurat
182	c)
183	c)
184	c)
185	c)